

STATUT

I SHOQERISE "Duraku-2022" SHPK

Me cilesine e "ortakut themelues " :

Hysret Duraku, i datelindjes 08 Dhjetor 1995, i lindur Gjakove-Kosove dhe banues ne Gjakove-Kosove, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar,identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftim ID 1736516, e vlefshme deri me date 10 Dhjetor 2025,i cili me cilesine e " Ortakut Themelues ", me kerkoi redaktimin e ketij akti themelimi, nepemjet te cilit ai deklarojne se me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin "**Duraku-2022**" shpk.

KREU I

Krijimi,Personaliteti juridik,Selia

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "**Duraku-2022**" shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit , në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**Duraku-2022**" shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Shoqeria e ka seline ne adresen: Ksamil,Lagjia Nr.2,Rruga nacionale Ksamil - Butrinti,,ndertese 1 kateshe me Nr.5,Ksamil- Sarande.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se ortakeve.



Neni 4

Objekti i veprimtarise

- Prodhimeve te brumit

Neni 5

Kohezqjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar , duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar Shqipetar.

KREU II
KAPITALI
Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 lekë.

Ky kapital perbehet nga kontributet:

Z. **Hysret Duraku** kontribon me shumen 100.000 leke.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i ndare në 1 pjesë.

Ne baze te kontributeve te mesiperme:

Z. **Hysret Duraku** merr 1 pjese te kapitalit themeltar me vlere 100.000(njeqindmije)leke.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar,shlyer plotesisht dhe jane shperndare ndermjet ortakeve si me lart.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e ortakeve.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem.

Administrator i pare i shoqerise eshte emeruar **Z. Hysret Duraku**, me nje afat pese vjeçar me te drejte rimerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asambleja e ortakeve te shoqerise.

Neni 12

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asambleja e ortakeve.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme. Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.



Neni 13

Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Ortakët kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortaku që nuk eshte administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e Asamblese se ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe Asamblese se ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.



Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga Asambleja e ortakeve, e cila jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

Neni 18

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve te të shoqerise.

Neni 19

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :

- a. Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"
- c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortakët e shoqërise, në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfitojne pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlere e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 22

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve debitorë që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë apo personave fizikë apo juridikë vendas apo të huaj.

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këto statute dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këto statute, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare", Kodit Civil, Ligjin për QKR, dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 24

Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25

Dispozita përfundimtare

Ky statut hartohet dhe nënshkruhet sot me dt.03 Qeshor 2022 në katër kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe, pasi miratohet në parim dhe nën për nën nga Ortaket themelues të shoqërisë tregtare "**Duraku-2022**" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet.

Ky statut hyn në fuqi menjëherë pas regjistrimit të tij në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

ORTAKU I SHOQËRISE

Hysret Duraku

